



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

/Prot

Shkodër, me 17.12. 2025

V E N D I M

Nr. 346 datë 17.12. 2025

**PËR MIRATIMIN E FUSHAVE PRIORITARE DHE BUXHETIT PËR
PROJEKTET PËR VITIN 2026 NË UNIVERSITETIN E SHKODRËS "LUIGJ
GURAKUQI "**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të larta në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1 germa *d*"; Statutit të USH-së neni 17, pika 6 germa *r* ; me vendim të senatit akademik nr.332 datë 17.12.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 17.11.2025:

Vendosi :

1. Miratimin e fushave prioritare dhe buxhetit për projekte të buxhetit 2026 në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi".
2. Saktësim i pikës VI "Kohëzgjatja, buxheti dhe financimi" pika 3, të VSA nr.332 datë 17.12.2025 **ishte:** *Vlera maksimale e financimit për projekt, do jetë deri në 300.000.00 lekë*
bëhet: *Vlera maksimale e financimit për projekt, do jetë deri në 300.000.00-500.000.00 lekë (materiali bashkëngjitur këtij vendimi.*
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc. Dr. Adrian LEKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

THIRRJE PËR PROJEKTE

Buxheti 2026

Përmbajtja

I. Baza Ligjore.....	4
II. Qëllimi i thirrjes.....	4
III. Objektivat e thirrjes janë:.....	4
IV. Fushat Prioritare	4
V. Kush mund të aplikojë.....	4
VI. Kohëzgjatja, buxheti dhe financimi	5
VII. Kriteria të përgjithshme për aplikim	6
VIII. Dorëzimi i aplikimeve	7
IX. Vlerësimi i projekt-propozimit	7
X. Miratimi për financim i projekt-propozimit	7
XI. Informacione të tjera.....	8

Shkurtime

BA

Bordi i Administrimit

DKSHN

Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit

KV


Komisioni i Vlerësimit

SA

Senati Akademik

USH

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”



Kjo është një thirrje për propozime për projekte të kërkimit shkencor, e financuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” me buxhetin e përcaktuar për “Fonde për projekte për kërkimin shkencor” për vitin 2026.

I. Baza Ligjore

Kjo thirrje për projekte publikohet bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë”, kreu VIII neni 95, Statutin e USH-së, kreu VII neni 67 dhe 68, “Rregulloren e Projekteve: mbi hartimin, zbatimin dhe menaxhimin e projekteve në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 295 prot., datë 18.11.2025.

II. Qëllimi i thirrjes

Qëllimi i thirrjes është mbështetja e veprimtarisë së kërkimit shkencor të stafit akademik të USH-së, përmes financimit me grante të projekteve kërkimore.

III. Objektivat e thirrjes janë:

- Të rrisë nivelin e indeksimit të USH-së në kërkim shkencor duke nxitur përfshirjen e stafit akademik në punë kërkimore cilësore
- Të rrisë cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet zhvillimit të metodologjive të reja mësimore dhe hartimit të materialeve didaktike inovative.
- Të përshpejtojë transferimin e dijes dhe inovacionit nëpërmjet zhvillimit të produkteve, prototipave, zgjidhjeve inovative dhe bashkëpunimit me aktore të tretë.
- Përmirësimi i imazhit të USH-së përmes rritjes së ndikimit social dhe komunitar me projekte që ndikojnë në zhvillimin e komunitetit lokal, rajonal e me gjerë.

IV. Fushat Prioritare

Thirrja mbulon fushat prioritare të kërkimit shkencor, si më poshtë:

Mjedisi, biodiversiteti dhe ndryshimet klimatike (*Projektet mund të adresojnë: Hulumtime /Vlerësime të biodiversitetit të zonave pak të studiuara; modelim të ndikimit të ndryshimeve klimatike në burimet ujore, pyjet ose bujqësinë; dixhitalizim/hartëzimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore etj.*)

Zhvillimi i komunitetit, përfshirja sociale dhe trashëgimia kulturore (*Projektet mund të adresojnë: Ruajtja e trashëgimisë kulturore jomateriale në veri të Shqipërisë; migrimi, angazhimi i të rinjve, barazia gjinore, jetesa rurale; analiza socioekonomike e shpopullimit në rajonet malore; fuqizimi i komunitetit përmes arteve, aktivitete sportive dhe aktiviteteve kulturore; mbrojtja dhe promovimi i gjuhëve dhe dialekteve të pakicave).*

Ekonomia qarkulluese dhe inovacioni ekonomik lokal, zhvillimi i qëndrueshëm, financat e gjelbra, turizëm i qëndrueshëm, sipërmarrjet lokale dhe modelet e bizneseve të

qëndrueshme (Projektet mund të adresojnë: zhvillimin e modeleve të eko-turizmit; hulumtim i tregu për produktet lokale në agro-turizëm, artizanate, bujqësi organike, sipërmarrjet në fushat e financës, kontabilitetit etj.).

Qeverisja, edukimi ligjor i publikut, reforma ligjore dhe qasja në drejtësi (Projektet mund të adresojnë: mbrojtjen e të drejtave të njeriut; kornizat ligjore për mbrojtjen e natyrës, përdorimin e tokës dhe krimet mjedisore; forcimin e qeverisjes lokale dhe vendimmarrjes pjesëmarrëse; iniciativat kundër korrupsionit dhe mjetet e transparencës së të dhënave, edukimi ligjor i publikut etj.).

Arsimi, inovacioni, IA dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor (Projektet mund të adresojnë: modernizimin e kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies në shkollë; iniciativat e arsimit STEM të lidhura me sfidat lokale mjedisore/socio-ekonomike; njohuritë dixhitale, inteligjencën artificiale dhe mjetet e arsimit shumëgjuhësh etj.).

Studime Albanologjike, përkthimi, diplomacia kulturore, dhe bashkëpunimi Ndërkombëtar (Projektet mund të adresojnë: Hulumtime mbi politikat gjuhësore në arsim dhe administratën publike; rolin e përkthimit të materialeve shkencore/historike; hulumtime rreth komunikimit ndërkulturor midis Shqipërisë dhe vendeve fqinje etj.).

Shëndetësia dhe shkencat mjekësore (Projektet mund të adresojnë: Hulumtime mbi sëmundje specifike; ndikimi i mjedisit në shëndetin e komunitetit; shëndeti i nënës, fëmijës dhe adoleshentëve; shëndeti mendor dhe kujdesi psikosocial; shëndeti Publik; shëndeti i migrantëve, minoriteteve dhe grupeve të cënueshme; siguria ushqimore etj.).

Llojet e projekteve të lartpërmendura janë sugjerime nga DKSHN-ja dhe aplikuesit mund të propozojnë projekte edhe jashtë kësaj liste, duke respektuar prioritetet e përcaktuara.

V. Kush mund të aplikojë

Në këtë thirrje kanë të drejtë të aplikojnë për financim si drejtues projekti vetëm stafi akademik me kohë të plotë në USH, ndërkohë që si pjesëtarë të stafit të projektit, përveç stafit akademik me kohë të plotë, mund të jenë edhe stafi akademik me kohë të pjesshme në USH dhe/ose ekspertë nga institucione të tjera (kur përfshirja e tyre në projekt është e mirë-justifikuar).

VI. Kohëzgjatja, buxheti dhe financimi

1. Kohëzgjatja për zbatimin e projekteve është **6 deri në 24 muaj**.
2. Buxheti në dispozicion të kësaj thirrje është buxheti i USH-së për thirrje për projekte për vitin 2026, në zërin buxhetor "Fonde për projekte për kërkimin shkencor" **6,000,000.00 – 7,000,000.00 lekë**
3. Vlera maksimale e financimit për projekt, do të jetë deri në **300,000.00-500,000.00 lekë**.
4. Grantet e alokuara në këtë thirrje mbulojnë shpenzimet, si më poshtë:

- a. Pajisje laborator (pajisje, kite, reagentë, etj.) të lidhura drejtpërdrejt me kërkimin shkencor që projekti parashikon të ndërmarrë. Për secilën pajisje aplikuesi duhet të japë disa elementë kryesorë të specifikimit teknik;
- b. Tarifa pajtim-abonimi (abonime në arkiva etj.);
- c. Programe soft të lidhura drejtpërdrejt me kërkimin shkencor që projekti parashikon të ndërmarrë;
- d. Libra, manuale dhe udhëzues të lidhura drejtpërdrejt me kërkimin shkencor që projekti parashikon të ndërmarrë;
- e. Botime (monografi, përmbledhje abstraktesh/*proceedings*, kosto botim artikulli në revista shkencore me faktor impakti);
- f. Shpenzime udhëtimi (akomodim, dieta dhe transport);
- g. Shpenzimet administrative për pritje-përcjellje për aktivitete (konferenca, seminare);
- h. Kancelari (postera, fletëpalosje, certifikata, çanta etj.);
- i. Pagesa honorari për ekspertët e jashtëm.

Komisioni i vlerësimit (KV) ruan të drejtën të mos e alokojë të gjithë shumën e vënë në dispozicion për këtë thirrje, në varësi të numrit të aplikimeve dhe cilësisë së tyre.

Lista e shpenzimeve të mësipërme është indikative dhe projekt-propozimi mund të parashikojë edhe lloje të tjera shpenzimesh në përputhje me natyrën dhe nevojat e tij. KV, në varësi të llojit të projektit, do të konsiderojë rast pas rasti pranimin ose jo të shpenzimeve të parashikuara jashtë listës së lartpërmendur.

VII. Kritere të përgjithshme për aplikim

1. Aplikimi për projektin e propozuar duhet të bëhet nga një pedagog i punësuar me kohë të plotë në USH dhe të ketë minimumi gradën Doktor i Shkencave.
2. Projekt-propozimi duhet të përmbajë vetëm veprimtari që lidhen me kërkimin shkencor, duke përjashtuar aktivitete siç mund të jenë: trajnimet, ngritje e kapaciteteve institucionale, aktivitete promovuese, advokuese apo monitoruese (kur këto përbejnë aktivitetet kryesore të projektit dhe nuk janë pjesë e kërimit shkencor).
3. Projekt propozimi duhet të përmbajë vetëm veprimtari që lidhen me kërkimin shkencor dhe në funksion të kërimit shkencor.

Do të kenë përparësi

1. Projekte të kërimit shkencor të cilat, adresojnë prioritetet strategjike kombëtare si dhe ato të Zonës Evropiane të Kërimit (European Research Area - ERA);
2. Projekte të kërimit shkencor që kanë lidhje direkt me prioritetet strategjike sektoriale të miratuara nga Qeveria Shqiptare sipas fushave prioritare;
3. Projekte të kërimit shkencor që vijnë si bashkëpunime ndërdisiplinore;

4. Projekte të kërkimit shkencor që vijnë si bashkëpunim i njësive me aktorë të sektorit privat, institucionet publike qendrore dhe vendore.
5. Projekt propozimet që mbështesin kërkimin shkencor në fushat prioritare duke përfshirë në këtë proces studentë dhe doktorantë aktual në USH;

VIII. Dorëzimi i aplikimeve

1. Projekt-propozimi dhe dokumentacioni i kërkuar sipas nenit 10 të Rregullores së projekteve, së bashku me shkresën përcjellëse të drejtuesit të projektit drejtuar DKSHN-së duhet të dorëzohen dorazi në 2 kopje fizike (të shtypura) dhe 1 kopje elektronike (CD ose USB) të vendosura në zarf të mbyllur, në zyrën e protokollit në Rektorat, brenda afatit të përcaktuar.
2. Kopja elektronike (në CD ose USB) duhet të përmbajë të njëjtin propozim të aneksit I dhe 2 si ajo e printuara e dorëzuar në protokoll.
3. Afati i fundit për depozitim të aplikimeve është data **19.01.2026**.
4. Projektet e dorëzuara jashtë afatit dhe që nuk respektojnë kriteret administrative të listuara në pikën 1 të këtij seksioni dhe formatet përkatëse, nuk do të merren në konsideratë për vlerësim.

IX. Vlerësimi i projekt-propozimit

1. Vlerësimi i projekt-propozimeve të dorëzuara për thirrjen përkatëse do të realizohet nga një komision *ad-hoc*, me përfaqësim nga njësitë kryesore, i ngritur me urdhër të Rektorit.
2. Për secilin projekt, vlerësimi realizohet nga të paktën 2 anëtarë përmes plotësimit të formës së vlerësimit individual të projekteve (shtojca 3), nga të dhënat e të cilave komisioni do të plotësojë formën e përgjithshme të vlerësimit të projekteve (shtojca 4).
3. Një projekt që të konsiderohet për financim duhet të marrë të paktën 70 pikë nga vlerësimi i përgjithshëm i anëtarëve të KV.
4. Rezultatet e vlerësimit për çdo projekt propozim, komisioni i përcjell tek DKSHN-ja, e cila njofton brenda 3 ditëve punë drejtuesit e projekteve për vendimin e komisionit për financim ose mos financim.
5. Në rastin e vendimit për financim me ndryshime dhe plotësime, stafi i projektit dhe drejtuesi i tij ka 5 ditë kohë nga marrja e njoftimit për të paraqitur përmes protokollit versionin e ndryshuar të projektit ku janë reflektuar të gjithë ndryshimet e rekomanduara nga komisioni. Ky version i rishikuar i projektit fiton statusin e projektit për financim. Në rast mosrespektimi të afatit për paraqitjen e plotësimeve, KV ka të drejtë të përjashtojë aplikimin nga lista e fituesve.

X. Miratimi për financim i projekt-propozimit

1. Projektet e klasifikuar për financim DKSHN i kalon pranë Administratorit për tu përfshirë në projekt-buxhetin e vitit pasardhës.

2. Projektet e klasifikuara për financim të përfshira në projektbuxhetin e vitit pasardhës kalojnë për miratim në SA dhe BA. Vetëm pasi ka marrë edhe miratimin e BA-së, një projekt-propozim konsiderohet i miratuar.
3. Në përfundim të procesit të miratimit, DKSHN-ja i bën me dije Vendimin e BA-së të USH-së drejtuesit të projektit duke vendosur në dijeni edhe njësinë kryesore dhe njësinë bazë nga ku ka ardhur projekt-propozimi dhe nis procedurat për nënshkrimin e kontratës me drejtuesin e projektit.

XI. Informacione të tjera

1. Aplikantët duhet t'i referohet "Rregullores së Projekteve: mbi hartimin, zbatimin dhe menaxhimin e projekteve në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 295 prot., datë 18.11.2025, ku do të gjejnë detajet e nevojshme mbi hartimin dhe dorëzimin e projekt-propozimeve, formën e aplikimit, udhëzime dhe detaje specifike lidhur me plotësimin e dokumentacionit për aplikim.
2. Projekt-propozimet që nuk kanë dokumentacionin e plotë, kanë pasaktësi në plotësimin e formës së aplikimit apo që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në Rregulloren përkatëse, do të s'kualifikohen në fazën e shqyrtimit.
3. Për sqarime më të hollësishme, lidhur me programet ose me procedurat e aplikimit, të interesuarit mund të drejtohen pranë Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit ose me e-mail në adresën: projects@unishk.edu.al
4. Udhëzuesit dhe Format e aplikimit mund t'i gjeni në faqen zyrtare të USH-së.